

PAULLINA SIMONS
FËMIJËT E LIRISË

ROMAN

BOTIMET TOENA

PAULLINA SIMONS

FËMIJËT E LIRISË

Roman

Përktheu nga origjinali anglisht
Desara Bregu

BOTIMET TOENA
Tiranë

Autori: Paullina Simons
Titulli në origjinal: Children of liberty
Botoi në anglisht: HarperCollins

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi
Përkujdesja grafike: Erdita Oshafi
Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817761

© Paullina Simons, 2012
© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollësja" nr. 71, Tiranë 1023.
Kutia Postare 1420
E-mail: botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al/>

Shokut tim të mirë, Nikut,
pa të cilin ky libër dhe shumë gjëra,
mund të mos ishin bërë kurrë.

Kishin gjithë botën para, njaftonte të vinin gishtin diku.

John Milton

Të gjithë të pashmangshëm;
Të gjithë pa kufij.

Walt Whitman

PJESA E PARË

VAJZA E BERBERIT

Dashuria, çfarë është dashuria? Një zemër e madhe që dhemb,
duar të rrudhura, heshtje dhe një dëshpërim i zgjatur...

Robert Louis Stevenson

Kapitulli i parë

Vajza e revolucionit

Në ishullin Elis kishte rënë zjarr, një vit përpara se Xhina të vinte në Amerikë, së bashku me të ëmën dhe të vëllanë, prandaj nuk erdhën nga porti i Nju-Jorkut, por nga ai i Bostonit.

Salvoja nuk kishte qenë fort mirë me humorin, që ditën që u larguan nga Napoli. Kishte lënë pas të dashurën e tij; ajo nuk ndahej nga familja. Kjo, veç të tjerash, e acaroi shumë. Refuzoi të qëndronte me vajzën që donte, por i mbajti inat familjes për vendimin që kishte marrë vetë.

- Ah, sikur Mimoja dhe Xhina të mund të shkonin vetëm në Amerikë, - tha me tallje.

- Nuk jemi të detyruar të ikim, Salvo, - i tha e ëma dhe e kishte seriozisht.

- Mimo! - bërtiti Xhina duke qarë. - Po babi çfarë do të thoshte?

- Babi, babi. Ku është babi, meqë është kaq i zgjuar?

Ishte verë dhe Xhinës i qanin sytë për një ditë të kthjellët, pa re. U ul në port majë gishtave dhe ia nguli sytë qiellit, me dëshirën për të parë në horizont, qytetin drejt të cilit kishin lundruar për javë të tëra, që do t'u paraqiste një copëz nga jeta që tashmë i priste. Teksa u shtriq, pa mjegullën e korrikut, vuri dorën mbi ballë, si për të qartësuar shikimin drejt asaj që kishte imagjinuar si bukuri urbane: qyteti që ziente, re tymi që ngriheshin në qiell, anijet që shkonin e vinin tutje-tëhu, qytetërim. Po nuk arriti të dallonte asgjë përveç mjegullës së dendur dhe melankolisë mbytëse.

- Hej, Salvo! - e thirri, pavarësisht se nuk dukej gjë. - Eja të shohësh!

Salvoja nuk shkoi të shihte. U ul pas saj si një thes në kuvertën kryesore dhe ndezi një cigare, ndërsa i hodhi dorën në qafë nënës së veshur me të zeza. Sapo kishin humbur babanë. Të pestë kishin planifikuar të shkonin në Amerikë për shtatë vjet, por vëllanë e madh të Xhinës e kishin vlarë në një sherr me thika, përpara gjashtë muajsh. Një turmë e dehur e kishte marrë përpara Antonion, e kishin zënë poshtë, kishte pasur probleme me policinë e njerëzit ishin shtypur nga kuajt. Antonion nuk e kishte kapur një thikë nga ato të ushtrisë, por nga ato të gjuetisë. Fundja, ç'rëndësi ka kjo; ai njësoj vdiq.

Ende pa mbushur tre muaj, të atin e la zemra.

Ai donte të ikte që kur fëmijët ishin ende të vegjël, por Mimoja nuk pranoi. Ajo nuk do të ikte pa para.

- Imagjino të shkosh në Amerikë, të nisësh një jetë të re pa pasur asgjë. Absurde!

Ajo nuk do të vinte në Amerikë si një provinciale varfanjake.

- Po ne jemi provinciale varfanjake, Mimo, e ka thënë Aleksandri i Madh.

Ai s'e zgjati më tej, nuk kishte kuptim. Nëna e Xhinës tha se kur të arrinte në Amerikë, donte të ecte me këmbët e saj, jo të hiqej zvarrë. Babai ra dakord, por pastaj ai vdiq.

Një pjesë e parave të Avitanove u shpenzuan për varrimin e Alesandros. Po Mimoja i kishte premtuar të shoqit se do të shkonte në Amerikë, pavarësisht nga gjithçka, kështu që një muaj pas varimit të tij, morën hua sa për tri vende të lira në anije. Në fakt, nuk i morën borxh, por i vodhën ato para: tezja e saj e madhe i kishte vjedhur paratë nga kutia që mbante gjyshi i verbër në kuzhinë, ku kishte lënë një shënim të cilin ai nuk e lexonte dot, që thoshte se "borxhi" do të paguhej, pasi Mimoja dhe fëmijët e saj të rimëkëmbeshin në tokën e huaj.

Salvoja, fëmija i mesëm, i tha Xhinës, të voglës, se gjiri i Masaçusestsit që derdhet në limanin e Bostonit, kishte pothuajse të njëjtën gjerësi sa oqeani që e furnizonte. Një sasi e madhe uji rridhte nga tre cepat e globit, rrethuar me ishuj të sheshtë, të gjelbër, shkëmborë. Faret ngriheshin rrëzë shkëmbinjve. Xhina ishte e etur për t'i parë këta farë, këta ishuj.

- Ky është problemi, Xhina, - tha Salvoja. - Nuk i sheh dot fare. Ato shërbejnë për të na ndriçuar rrugën. Nuk arrin t'i shohësh as nga mjegulla. Gjithmonë kështu është. Nuk sheh dot asgjë, derisa të dalin shkëmbinjtë përpara dhe rrezikon të përplasësh. Pak a shumë siç ndodh në jetë.

E vrenjtur, Xhina iu largua të vëllait, ndërsa ai dukej i kënaqur, sikur t'i ishte plotësuar dëshira. Ajo vështroi ujin, duke menduar se me çfarë instrumentesh, dhe mbi të gjitha a ekzistonin instrumente, me të cilat mund të lundroje në ato ujëra, të cilat dukeshin shumë pak.

- Të lutem, mos na përplas me shkëmbinjtë kur të jemi afër. Kemi gjasa?

- Nëse nuk sheh se ku shkon? Ka shumë gjasa, - u ngërdhesh Mirkoja.

Ishte shumë i zoti për t'u ngërdheshur. Kishte fytyrë elastike, ideale për të përqeshur e për t'u ngërdheshur. Tangërlëku i tij ishte bezdisës.

Ajo shkoi nga skaji deri tek ura për të folur me ndihmëskapitenin, i cili qëndronte si një monument në hark, duke parë përmes një teleskopi. Çfarë përqendrimi mbresëlënës! Ajo i tregoi atë që i kishte thënë i vëllai dhe i kërkoi që ta mohonte.

- Ai ka të drejtë.

- Si mund të shmanget përplasja e anijes?

Adjutanti ia tregoi. Në hartën blu, shenjat e zeza ovale, ishin rrethuar me të kuqe.

- Këto përpiqemi t'i shmangim.

- Si?

- Duke lundruar larg rrezikut. Kemi një hartë.

E tregoi me gisht, i paduruar. Ajo iku.

- Po sikur të mos e dish ku është rreziku? - iu drejtua atij. - Po nëse s'ke hartë?

- E po, s'mund të nisësh në udhëtim pa e ditur se ku po shkon, apo jo? - ia ktheu ai, sikur i mbylli gojën.

Anija dukej se qëndronte në drejtimin e duhur, megjithëse ishte e vështirë të dallohej. Gjiri poshtë dukej njësoj si qielli lart, si graniti. Frynte një erë fshikulluese dhe ujërat ishin të rrëmbyeshme.

Nëna e Xhinës filloi të nxirrte përsëri. Udhëtimi kishte qenë relativisht i qetë, përveç të vjellave.

Stomaku i Mimos nuk mund të duronte atë që për Xhinën dhe Salvon nuk përbënte asnjë problem.

“S’është e lehtë të jesh plakë”, mendoi Xhina, teksa i solli të ëmës një peshqir të pastër dhe një qese të re. Megjithatë, Mimoja mbahej e fortë: afro dyzetepesëvjeçare dhe po nisej drejt perëndimit, në kërkim të mundësive që s’i shihte askush.

- Ti s’para je kaq e emocionuar, - i tha Salvoja Xhinës, teksa e pa që ecte nëpër kuvertë, duke thithur ajrin e oqeanit.

- Për ty vlen e kundërta, - iu përgjigj ajo. - Velat janë të mbushura me erë. Pse u nisëm me qëndrimin tënd?

- Hë pra, pse? - murmuriti Salvoja.

- Kështu donte babi. Do të dalësh kundër vullnetit të babait tënd?

- Nuk e kishim planifikuar kështu, - tha vëllai i saj.

Xhina nuk donte t’ia pranonte Salvos gërnjar se kënaqësia e saj u zbeh kur nuk mund të shihte se ku po shkonte. Ajo e kishte imagjinuar ndryshe: diellin e shndritshëm, drita vezulluese, ndoshta një perëndim në horizont, ndërtesa të larta për t’u uruar mirëseardhjen, një ftesë dramatike në jetën e re, një udhëtim i mundimshëm që përfundonte me një peizazh plot ngjyrë. Nuk priste mjegullën gri.

Ajo qëndroi te kangjellat e kuvertës, në kërkim të një shenje, me shpresën se do ta gjente.

Ashtu siç kishte ëndërruar babai, fëmijët që i kishin mbetur, do të ndërtonin një jetë të re në tokën e pafundme e frymëzuese.

Ndërsa Mimoja rrinte dorështrënguar, babai i mësoi fëmijët e tij të lexonin që të mos ishin analfabetë. Më pas u mësoi anglishten. Xhina dinte të lexonte e të fliste pak anglisht. Flokët e saj të valëzuar po ngatërroheshin, teksa qëndronte në anën nga frynte era, mes ujit të paanë. Mimoja e kishte urdhëruar t’i lidhte pas, por me atë fustan blu të çelët, me krahët e saj të gjatë e të nxirë, me flokët që fluturonin në shi, në sfondin e mjegullës së hirtë, ajo dukej tmerrësisht tërheqëse. Veç të mund ta pikturonte dikush, teksa ajo kërkonte Amerikën dhe era luante me flokët e

saj! U kënaq duke e menduar këtë pamje. “Sigurisht, ne mund të përplasemi me shkëmbinjtë siç parashikoi Salvoja, por kështu do të qëndrojmë në minutat e mia të fundit, krenare dhe pa frikë.”

Thellë-thellë, Xhina nuk e besonte se do të përplaseshin. Ajo e mendonte veten të pavdekshme, si e gjithë rinia.

Më në fund, pati ftohtë dhe shkoi u ul pranë familjes. Rrinin ulur të tre si thasë, me duart në gjunjë, e ëma mbante rruzaren në duar dhe, pa zë, lëvizte buzët duke thënë: “Shën Maria” si dhe thirrjet e Zotit: “Mari, që të shpoi shpata shpirtin”. E tha me zë të lartë që ta dëgjonte Xhina e të mund t’i përgjigjej, duke vazhduar: “Lutu për ne”. Po Xhina nuk ishte në gjendje të lutej, kështu që u përkul pa bërë zë; edhe e ëma u përkul, iu afrua Salvos, i cili e kapi prej dore dhe jehoi:

- Lut u për ne.

- Mendon se Xhina po vuan, Salvo? - e pyeti Mimoja, pavarësisht se Xhina ishte ngjitur me ta dhe mund ta dëgjonte.

- Sigurisht, Mimo. Thjesht e fsheh, vuan në heshtje.

- S’ka mundësi! - thirri Mimoja. - Kur të ka keq shpirti, e kuptojnë të gjithë. Nuk janë gjëra që mund të mbahen fshehur këto.

Pas një grimëkohe që nëna e tyre i nguli sytë Xhinës, Salvon e kaploi një heshtje e dukshme. Xhina e dinte se i vëllai ia njihte aftësinë për t’i fshehur gjërat. Ajo mbajti të fshehtë pëlqimin e saj të parë (gjë që nuk është aspak e lehtë, në një qytet ku të gjithë e njohin njëri-tjetrin). Mbajti të fshehtë edhe faktin që piu shumë verë në festën e Theotokisit të shenjtë, edhe faktin që nuk shkante të rrëfehej çdo javë. A ishte ky një mëkat në vetvete? Edhe notat e ulëta i fshehu, madje edhe faktin që nuk dinte anglisht aq mirë sa mendonte babai i saj. Hiqej sikur e dinte mirë.

Çdo gjë që duhej ta mbante për vete, Xhina nuk e ndante me askënd. Si për shembull, ankthin që po ndiente tani. E shqetësonte kontrasti i thellë mes pritshmërisë për një mbërritje të diellit dhe verbërisë së oqeanit nëpër të cilën po lundronte anija. Shkoi sërish për të gjetur nënkapitenin.

- Si mendon, sa larg jemi? - e pyeti.

Ai ia tregoi me gisht. U duk sikur tregoi rrotën që po mbante.

- Doket janë më pak se një kilometër larg. Çfarë, nuk i sheh?

Kur vrapoi t'i tregonte vëllait dhe të ëmës se pothuajse kishin arritur, ata nuk e besuan. Kishin të drejtë, sepse u deshën edhe dy orë për të arritur në breg. Me not do të kishte arritur më shpejt. Po i ikte truri nga padurimi dhe mërzia.

- Ku është zjarri? - pyeti Salvoja. - Për ku gjithë ky nxitim? Çfarë mendon se do të ndodhë kur të ecësh në breg? Mendon se do të të ndryshojë e gjithë jeta, sapo të zbresësh nga anija?

Kështu kishte menduar Xhina përpara një jave, diku pranë Islandës. Po pyetjes së tij të ashpër, iu përgjigj:

- Mos u bëj kaq negativ, Salvo. Asnjë vajzë amerikane nuk do të të pëlqejë kështu.

- Kush të tha se dua një vajzë amerikane?

Foli ashpër, pastaj i kërkoi faljes Mimos. Zakonisht, i merrte gjërat me sportivitet. Nuk mund të rrinte gjatë i mërzitur. Fakti që ishte i bukur dhe me humor të mirë, i siguronte qetësinë, sa herë kishte nevojë. Këtë pasdite të vonë, u ulën shpatull më shpatull te direku, teksa shihnin doket që lidheshin me varkën. Pavarësisht se ishte vajzë dhe katër vjet më e vogël, Xhina kishte pothuajse të njëjtën peshë me Salvon, por më e gjatë. Askush nuk e kuptonte se kujt ia kishte marrë gjatësinë: as vëllezërit, as prindërit, s'i kishte të gjatë.

- Pa shiko, - do të thoshin fshatarët. - Dy vëllezër shkurtabiqë dhe një motër e gjatë.

- Sepse jemi me baballarë të ndryshëm, - do t'u përgjigjej Xhina, thatë.

Salvoja i gjuante me kokë, sa herë e dëgjonte.

- E kupton ç'po thua për nënën tonë? - i hakërrehej, duke ndëshkuar veten dhe atë për paturpësinë.

Kapitulli i dytë

Djemtë e lirisë

Xhina ishte e trullosur nga qëndrimi për një kohë të gjatë në det. Kaluan në tendën e kontrollit shëndetësor, përpara se t'i lejonin të hidhnin këmbën në tokë. Nuk kishte sy që rridhnin, as skuqje të pashpjegueshme, asnjë grua beqare që udhëtonte vetëm, të gjitha dokumentet në rregull. Ngadalë, tërhoqën valixhet pas vetes.

- Nuk ndihem shumë mirë, - tha Mimoja. - Ku jemi?

Xhina hodhi sytë përreth për ndonjë shenjë.

- Një vend diku quhej “Skela e gjatë” ose “Doket e Lirisë”, - tha ajo duke treguar me gisht.

Flokët i kishte kapur bisht, siç e kishte urdhëruar Mimoja.

- Je thjesht e emocionuar, Mimo, - tha Salvoja. - Ulu, eja në vete!

- Je budalla, Salvadore, - tha e ëma.

- Nuk jam.

Mimoja ishte një grua e fortë, e veshur këmbë e kokë me të zeza.

- Nuk kam mbajtur gjë për gjashtë javë. Nuk jam shumë e emocionuar.

Të gjithë u ulën të pushonin mbi një mur të ulët, pranë ujit. Shumë njerëz kishin dalë nga anija përpara tyre, kështu që shumë prej vendeve buzë ujit, ishin të zëna nga familjet e tjera.

Nëna u lut, vëlla e motër u çliruan dhe panë njëri-tjetrin në sy. Po tani ku do të shkonin? Ku mund të merrnin pak ujë? Ishte rrëmujë dhe kishte shumë zhurma, një tufë pulëbardhash përplaseshin në pritje të ushqimit.

- Zonjë, zotëri, zonjushë! - u dëgjua një zë i fuqishëm mashkullor në të djathtë të tyre.

Teksa u kthyen nga erdhi zëri, u përballën me dy të rinj amerikanë, më i gjati mbante në duar një kanë me ujë dhe bukë, tjetri një shportë me thurje të mbushur me mollë të kuqe dhe thagma në formë gjysmëhëne me lëkurë të verdhë të trashë.

- Zonjë! - thirri sërish i shkurtri, më miqësori nga të dy.

Hoqi kapelën strehëgjere, iu përkul dhe u kthye me fytyrë nga Xhina. Kur u drejtua, i buzëqeshi vesh më vesh, duke i ngulur sytë e tij kaf. Ngjante si shumica e djemve të qeshur. Ishte i lexueshëm në fytyrë, i egër, i shoqërueshëm.

- Dukeni të lodhur e të etër, ju lutem, na lejoni t'ju ndihmojmë, ne kemi ujë.

Duke ulur shportën, i rrëmbeu me mjeshtëri kanën shokut të tij dhe u hodhi ujë në një filxhan të vogël metalik, të cilin ia dorëzoi Mimos që qëndronte ulur.

- Këtu, zonjë, pi. Kemi pak bukë. Heri, jepi pak. Do të donit të provonit një banane?

Ai ngriti shportën për t'ia treguar Xhinës.

- Janë një delikatesë e jashtëzakonshme nga Amerika e Jugut dhe së shpejti do t'i njohë e gjithë bota.

Xhina donte mollën, por do të ishte e sikletshme për ta ngrënë. Nuk donte t'i kullonte lëngu nga mjekra, teksa përpiquej të ngjante si zonjë me finesë. Salvoja, i pashqetësuar për lëngun në mjekër, rrëmbeu mollën. Të gjithë i shikonin bananet me mosbesim.

- Unë jam Ben Shou, - i tha i riu miqësor. - Kënaqësi e veçantë t'ju njoh, - buzëqeshi ai.

Djaloshi i gjatë, i qetë, bëri një hap përpara.

- Do të doje pak bukë apo vetëm ujë?

Ishte me flokë të zhuritur dhe me fije, por kishte veshur një kostum me jelek dhe kravatë, megjithëse këmisha e bardhë e futur më parë në niseshte, po i dilte nga pantallonat dhe kravata i rrinte shtrembër.

Një prej manshetave të tij prej ari ishte gati të binte. Babai i Xhinës do ta kishte pëlqyer; ai nuk ishte i zhurmshëm. Ai kishte sy të zgjuar, seriozë. Për Xhinën, ai ishte i turpshëm, gjë që e

tërhoqi shumë. E shikonte me qetësi, jo në mënyrë miqësore, por as shpërfillëse. Ajo i buzëqeshi, pa drojë, duke i treguar dhëmbët e saj italianë, sytë me shkëlqim dhe fytyrën e saj të skuqur.

- Do të marr pak bukë, të lutem, - tha ajo në anglisht. - Përshëndetje! - zgjati dorën. - Unë jam Xhina.

- Unë jam Haroldi, - tha ai, duke u zgjatur përpara. - Heri, gëzohem që u njohëm...

Përpara se të mbaronte fjalinë ose ta prekte, Salvoja u fut mes tyre, me shpinë nga e motra.

- Unë jam Salvadore Ataviano, - tha ai, duke i tundur dorën Herit. - Vëllai i madh i Xhinës.

Ajo nuk pati zgjidhje tjetër, veçse të tërhiqej, duke turfulluar nga zhgënjimi, teksa shtrëngonte vëllanë e saj qesharak nga supet.

- Do të doja pak bukë, Salvo, - tha e acaruar. - Ka ndonjë problem këtu?

Salvoja këputi një copë nga buka e Herit dhe ia dha. Ajo ia mori rrëmbimthi.

- Kjo është nëna jonë, Maria, - u tregoi Salvoja dy burrave. - Po të gjithë i thërrasin Mimo.

- Edhe fëmijët? - buzëqeshi Beni.

- Sidomos fëmijët, - tha Xhina, duke lëvizur sa andej-këndeje. Beni i solli pak bukë Mimos.

- Për ku jeni nisur? - pyeti. - Mund t'ju ndihmojmë unë dhe Heri, t'ju çojmë diku? Kemi një karrocë në pritje.

Mimoja tundi kokën fuqishëm, që nga muri ku ishte ulur.

- Nuk mund të eci, më janë ënjtur kyçet. Salvo, thuaji që do të na bënte goxha nder po të na çonte.

- Duhet të shkojmë te stacioni i trenit, - tha Salvoja. - Do të shkojmë në Lawrence.

- Lawrence! - bërtiti Beni. - Si kështu?

Xhina filloi të fliste, të shpjegonte kuptimin e Lawrence-it, por Salvoja e ndërpreu.

- Këtu do të shkojmë. Çfarë ka?

Beni ngriti supet, i paprovokuar.

- Asgjë s'ka, - tha. - Thjesht po përpiqem t'ju ndihmoj.

Ata u grindën në dy gjuhë gjysmake.

- Më ndihmo duke më treguar stacionin e trenit, - iu kundërpërgjigj Salvoja.

- Në rregull, por duhet të flini në stacion. Treni i fundit ishte në orën katër.

Heri e shtyu në shpinë me grusht dhe rrotulloi sytë. Beni nuk ia ktheu vështrimin. Të gjithë ngritën sytë nga kulla e sahatit në qendër të qytetit. Katër e pesëmbëdhjetë, shënonte ora. Salvoja shfryu jo dhe aq nën zë.

- Si thoni, - tha Beni me zë të gjallëruar, - sikur të shkoni nesër? Sot rrini tek një nga apartamentet tona. - Tundi kokën, teksa pa fytyrën e Salvos. - Pa pagesë, si mysafirët tanë.

- Përse do ta bënit këtë? - pyeti Salvoja me dyshim. - Çfarë përfitoni ju?

Heri vazhdonte t'i binte Benit në shpatulla, sikur donte ta ndalonte së foluri. Beni bëri pas.

- Heri, nuk ka problem. Është vetëm një natë.

Ai i buzëqeshi Xhinës, e cila rrinte ende gjysmë e fshehur pas Salvos.

- Unë bashkë me shokun tim menaxhojmë disa ndërtesa këtu pranë, të banuara nga italianë si ju. Japim apartamente me qira, ju ndihmojmë të gjeni punë, ju huazojmë para.

Sikur Salvoja t'i kishte pasur sytë pak më të vegjël, do t'i ishin mbyllur fare.

- Pse e bëni? Si formë bamirësie?

- Po, pak a shumë.

- Nuk kemi nevojë për bamirësi, - tha Salvoja. - Nuk jemi të varfër.

- Atëherë, s'është bamirësi, - ia ktheu Beni me po aq vendosmëri. - Jo, zotëri. Është huadhënie. Ju japim paratë dhe ju na i ktheni kur të gjeni punë.

- Ne nuk marrim kurrë para hua, - tha Salvoja, - aq më tepër nga të huajt.

Beni e pa si i mposhtur. Xhina tundi mëngën e Salvos. Ishte e turbullt dhe të gjithë ishin djersitur. Dielli nuk po shkëlqente, megjithatë ishte shumë i nxehtë dhe ajri nuk lëvizte. Kur kishin qenë në det, bënte freskët e frynte erë. Tani dukej sikur ishin

ndezur menjëherë furrat e qymyrit. Xhina nuk e dallonte ajrin shtypës të tokës, pikat e djersës që rridhnin nga balli i saj. Njëra iu fut në gojë. E lëpiu fshehtas, duke u përpjekur të ngjante më interesante. Dalloi syrin e kënaqur, por të largët të Herit. Të dy burrat kishin veshur kostume, të cilët dukeshin me cilësi të mirë. Por për disa arsye, Heri dukej sikur kishte lindur me kostum, ndërsa Beni dukej sikur e kishte marrë borxh.

- Lëri, Beni, - tha Heri, duke e larguar shokun. - Do të jenë mirë. - Ai tregoi me gisht një familje tjetër me pesë ose gjashtë anëtarë, që mbanin plaçkat e tyre. - E provojmë njëherë me ata.

- Jo! - Xhina u rrotullua drejt nënës së saj me lutje dhe drejt vëllait në mënyrë akuzuese, duke e goditur, duke i dalë përpara. - Bëhet fjalë vetëm për një natë, Salvo, - pëshpëriti ajo vullshëm. - Mos u bëj kaq budalla.

Situata kërkonte përgjigje menjëherë. Nëse Salvoja do të këmbëngulte në të tijën, dy burrat e veshur mirë, do të ishin duke ndihmuar familje të tjera.

Salvoja tundi kokën.

- Jo, Xhina. Është natë shumë e gjatë. Nuk mund t'ua kthejmë.

- Nuk keni pse të na i ktheni, - ndërhyri Beni, i cili i dëgjoi së largu. - Seriozisht, apartamenti është i mobiluar dhe nuk banon njeri në të. Përdoren si dhomë hoteli. Nëse doni, mund të paguani darkën dhe nesër në mëngjes të niseni për në Lawrence.

Benit i lexohej në fytyrë mendimi: “edhe pse arsyeja që do të doje është përtej meje”, ndërsa Salvos: “Më mirë fle në rrugë si pijanec, sesa të pranoj një nga dhomat tuaja”.

Mimoja i vuri pikat mbi i.

- Salvo, nëna jote është e lodhur. Falënderoji këta burra. Pranojmë.

Xhina sa nuk duartrokiti. Falë Zotit, nëna e saj ishte pragmatiste. E dinte që Salvoja s'do ta ulte kurrë hundën; ishte tepër krenar. Asnjëherë s'e kuptoi këtë. Mos vallë ajo nuk kishte fare krenari? Nuk mendonte ashtu. Thjesht nuk do ta lejonte krenarinë idiote ta pengonte për gjërat që donte dhe donte vërtet shumë të shikonte se çfarë do t'i ofronin këta djem të rinj familjes së saj.

- Krenaria është mëkat i rëndë, Salvo, - i pëshpëriti në vesh, teksa nxitonin për të ndihmuar të ëmën.

- Ashtu si epshi dhe dembelizmi, - iu kundërpërgjigj ai.

- Karroca jonë po ju pret atje, - Beni iu drejtua Mimos, duke e kapur me zell nga bërryli dhe duke i treguar “Doket e Lirisë” drejt qytetit, ku qëndronin rresht disa vagonë të tjerë.

- Nuk e keni problem të shkoni me këmbë?

Mimoja i buzëqeshi Benit. Salvoja, i cili pa gjithçka, pëshpëriti një fjalë të keqe.

- Djalosh, sapo kam bërë gjashtë mijë kilometra. A do të eci dot njëqind metra? Shkojmë, prit të të kap prej krahu.

Xhina ecte pas Benit dhe Mimos, duke e tërhequr vetë valixhen e saj, tejet e kënaqur. Salvoja tërhiqte pjesën e mbetur të valixheve.

- Ku ke mësuar të flasësh italisht, djalosh? - Mimoja pyeti Benin.

- Di vetëm ndonjë fjalë tek-tuk, sa për të na ndihmuar me biznesin. Shumica e emigrantëve që përshëndesim janë italianë.

Ajo ia miratoi me njëfarë vlerësimi.

- Je djalë i mirë për nënën tënde? - e pyeti.

- Jam djalë, - iu përgjigj ai.

- Ajo duhet të jetë krenare për ty, - Mimoja pa Xhinën që po ecte krahu Herit dhe u vrenjt. - Ju të dy jeni vëllezër?

- Në shpirt, - tha Beni, - në shpirtin e shenjtë.

Salvoja, jo vetëm që arrinte të tërhiqte dy valixhet më të mëdha, por edhe ecte para të gjithëve, sikur ta dinte se ku po shkonte.

- Vëllai yt po na udhëheq? - pyeti Heri me qetësi e duke ngritur supet. - Në mbretërinë e të verbërve, ai që ka një sy është mbret.

Xhina nuk e kuptoi mirë, por s’mund të fliste kundër vëllait të saj me një të huaj, as për batutë. Para se të mund të mendonte për diçka të mençur për të thënë, Mimoja u shkëput nga Beni dhe i bëri shenjë të vinte.

- Xhina, eja këtu, ec me mua. Le t’i mbajnë burrat gjërat e rënda.

Xhina nxitoi, kapi Mimon nga bërryli, duke e lënë Benin të lirë që t’i tregonte Salvos rrugën e duhur për të kalë e karroca.

- Nëna jote është grua e mrekullueshme, - iu drejtua Beni, Salvos, teksa ndaloi te një pelë gri.

Salvoja e pa me përbuzje. Në italisht, i tha:

- Tani po përpiqesh t'i shkosh pas nënës sime, ti?

Beni nuk i kuptoi fjalët, por e kapi thelbin. Ndaloj së qenët miqësor me Salvon dhe zgjidhi rripat e vagonit të hapur. Pela dukej se nuk do t'i mbante dot valixhet gjatë udhëtimit. Dukej se s'do t'ia dilte dot në nxehtësinë e mbrëmjes.

Pasi ngjitën gjithë gjërat, Mimoja dhe Xhina hipën lart, u ulën në pjesën e hapur të karrocës, me fytyrë nga rruga, ndërsa Beni dhe Salvoja në anën e kundërt dhe Heri shkoi te vendi i drejtuesit, duke marrë në dorë frerët. Pela u përkul përpara dhe, me lëvizjen e saj kërcitëse, gati sa nuk i zgjidhi litarët e lidhur me kujdes nëpër valixhe. Beni e këshilloi mikun e tij që të ishte më i kujdesshëm.

- Do të mundohem, - tha Heri, - por ti e di, është hera e parë që kam frerët në dorë.

Beni qetësoi Mimon.

- Po bën shaka. Heri, mjaft, po na i tremb pasagjerët tanë të dashur.

Edhe Mimoja buzëqeshi me dashamirësi, që ai e quajti "të dashur". Salvoja dukej sikur donte t'ia fuste me grusht.

- Zgjat shumë?

- Jo shumë, por është kohë darke. Do të ketë shumë trafik. Jemi rreth 1 kilometër e 600 metër larg. Jemi nisur në drejtim të një zone të Bostonit që njihet si "Fundi i Veriut". Keni dëgjuar për të?

- Unë jo, - tha Xhina. - Është bukur atje?

- Do ta shohësh, - i buzëqeshi Beni.

Ajo ia ktheu buzëqeshjen. Salvoja ia nguli sytë, ndërsa asaj i ngriu buzëqeshja në fytyrë nga shikimi i të vëllait.

- Çfarë ka në Lawrence?

- Kushërira jonë, Anxhela jeton atje, - tha Salvoja, për t'i tërhequr vëmendjen Benit. - Ajo po na pret. Mendon se do të arrijmë sot. Ne do të jetojmë me të.

- Do t'ju gjejë punë kjo Anxhela? - pyeti Beni.

- Sigurisht.

Beni ia hodhi shikimin Xhinës:

- Çfarë do të donit të bënit ju, zonjushë Ataviano?

- Të lutem, më thirr Xhina, - i buzëqeshi ajo. - Mua më pëlqen të notoj.

- E po, nuk e di nëse mund të të gjej ndonjë punë që të notosh, - ia ktheu ai. - Si mendon ti Heri?

Heri nuk foli dhe Mimoja u ul me kapelën e saj që i binte mbi sytë me qepalla të rënda; dukej sikur as shihte, as dëgjonte se ç'po ndodhte përreth. Befas, iu drejtua Xhinës në italisht:

- Xhina, mendo çfarë mrekullie. Së shpejti do të festojmë ditëlindjen tënde në një vend të ri.

- Po, sa mirë! - ia ktheu Xhina, e hutuar nga ndryshimi i papritur i bisedës dhe hapi gojën që të vazhdonte të fliste me Benin për pasionet dhe interesat e saj si: vrapimi, mbjellja e luleve, përgatitja e salcës së domateve, buka e shijshme e thekur dhe këndimi.

Mimoja i hapi sytë ngadalë, duke kërkuar shikimin e Benit, për t'u siguruar që ai po e dëgjonte.

- Duhet të bëjmë diçka të veçantë për pesëmbëdhjetëvjetorin tënd, si thua? - i tha së bijës. - Ti Salvo, si mendon?

- Të duket sikur më intereson kjo tani, Mimo? - ia ktheu Salvoja, i lodhur, megjithatë sypetrit.

Dikujt, ama, i interesonte. Benit. Vërtet, ai theksonte se dinte shumë pak italisht, por ia doli të kuptonte të vetmen gjë me rëndësi nga biseda e tyre: moshën e brishtë të vajzës së vetme të Mimos. Xhina ishte vetëm pesëmbëdhjetë vjeçe.

Fytyra e tij e zhgënjyer i tha të gjitha. Mbi kokën e Benit, shpatullat e holla të Herit u përplasën lart e poshtë, sikur po qeshte.

- Më falni pak, - tha Beni dhe ia behu në këmbë. - Shoku im nuk e di ku po shkojmë. Duhet ta udhëzoj.

Ai u ul pranë Herit, duke i marrë nga duart frerët.

Xhina uli mbulesën mbi sytë e saj, për t'iu fshehur zhgënjimit të amerikanit. Mimoja ishte shumë ngatërrestare, po cili ishte dëmi, fundja?

- Ta tregoj unë dëmin, - pëshpëriti Mimoja, në gjysmëfshehtësi. - Je shumë e vogël për të pasur vëmendjen e tyre. Më dëgjion? Nuk je në Belpaso këtu e po vrapon zbathur në grykat e pluhurosura, bashkë me fëmijët. Këta janë burra amerikanë. Mund të jenë më të mëdhenj edhe se i vetmi vëlla që të ka mbetur gjallë. Këtë mendon se donte yt atë për ty? Të krijosh familje në këtë moshë, me djem që janë në të njëzetat? Je shumë e re!

- Familje? Ç'thua? Ne thjesht po bisedonim.
- Si mendon ti se fillon, o fëmijë naiv? Mendon se bëhet fëmija direkt?
- Mimo! - fërshëlleu Xhina e mërzitur. - Nuk dua të flas për këtë me ty.
- E saktë. Nuk diskutohet fare kjo temë. Qëndroju larg!
- Duke iu larguar së ëmës, Xhina bëri përpara, për të dëgjuar më mirë se çfarë po murmurisnin Beni dhe Heri.
- Po qyteti ishte shumë i zhurmshëm, trak-truket e pelës kërcisnin fort në dysheme dhe Mimoja e tërhoqi sërish të bijën pas vetes, që ta kishte afër.
- Të thashë, - po i thoshte Heri, Benit. - Të paralajmërova. Qëkur e pamë nga larg. E mban mend ç'të thashë?
- Po, po, më the se ishte problematike. E kishe gabim dhe gabim e ke ende.
- Benjamin, unë marr vesh nga këto punë, ajo është problematike.
- Ti nuk di asgjë përveç idiotësive që nxjerr nga ata librat e pakuptimtë që s'të mësojnë asgjë për jetën. Ti nuk di të jetosh.
- Ti di?
- Po, di. Ajo s'është problematike. Ajo është vetë jeta.
- Heri rrotulloi sytë:
- Je akoma më budalla. Si e kupton ti fjalën problematike?
- Ajo është vajzë fatale, - tha Beni.
- Jepi kohë, Benjamin. Ajo është çupëlinë fatale, vetëm katërmbëdhjetë vjeçe.
- Me shpatullat e varura, Beni u largua nga Heri që tallej.

Kapitulli i tretë

“Veriu i Fundit”

“Veriu i Fundit” ishte një livadh matanë Bostonit, që ngrihej nga bloza dhe nxehtësia e qymyrit të pasdites. Dukej paksa i shkëputur, si i ndarë nga pjesa tjetër e Bostonit përmes këtij kufiri natyror. Dukej të kaloje një fushë të mbuluar me pleh organik përpara se të hyje në rrugën “Salem”, e cila shtrihej dhe kalonte pranë një kishe të lartë, pranë tregtarëve që shisnin mallrat e tyre, pranë dyqaneve dhe tezgave. Një grup trombësh luante me zë të lartë në një bllok tjetër; dëgjoheshin të bërtitura fëmijësh dhe të bërtitura nënash. Burrat rrinin rreth e rrotull dhe pinin duhan; aroma e qytetit ishte e fortë, trafiku me njerëz, kuaj dhe tramvaje ishte i egër, pothuajse i çmendur. Secili lëvizte nga një pjesë të trupit, buzët u lëviznin me shpejtësi, këmbët s’dinin ku i çonin, duke mbajtur me vete çantat, karrocet e fëmijëve, ëndrrat dhe ombrellat.

Për Xhinën, ishte dashuri me shikim të parë. E hapi gojën, duke harruar nënën, vëllanë, madje edhe djalin e heshtur me flokët ngjyrë rëre, që e vështroi te “Doket e Lirisë”. Ajo u ul pranë Salvos, i cili, për arsye të pakuptueshme, dukej më pak i magjepsur.

- Shenjtja nëna e Hyjit, - tha ai. - Kjo është e tmerrshme.

Xhina puliti sytë.

- Çfarë? Jo, është krejt e kundërta, Salvo. Shikoje!

- Babi më ka folur për Milanon. Tha se ishte kështu.

- E po, nëse babi donte që ne të shkonim në Milano, atje do të kishim shkuar, - tha Xhina. - Ai donte të vinim në Amerikë dhe ja tek jemi. Është mrekulli!

- Lëre ta shijojë, Salvo, - tha Mimoja. - Yt atë do të lumturohej po ta dinte se asaj po i pëlqen.

Qortimi i së ëmës, vetëm sa e shtoi mërinë e Salvos ndaj Xhinës.

Xhinës nuk i interesonte asgjë. Ishte përqendruar te qyteti.

Burri me organo prej fuçie luante “Santa Luçia” nga vendlindja e Xhinës. Ishte e befasuar që mund ta dëgjonte atë gjatë gërvishtjeve dhe kërcitjeve të kuajve, ulërimat nga karrocat elektrike për të cilat kishte dëgjuar të atin të fliste, por kurrë nuk i kishte parë, grumbujt e njerëzve në orët e pikut, shitësit që bërtisnin italisht duke shitur hudhra dhe duhan, kumbimin e kambanave të kishës në cepin e “Salem”-it dhe “Prince”-it, ndoshta duke njoftuar se ishte ora gjashtë dhe kishte ardhur koha e meshës.

Karrocat nuk lëviznin, kuajt me vështirësi; rrugët ishin tejmbushur dhe Xhina kishte frikë se nga çasti në çast, do të shpërthente një zënkë, sepse njerëzit qëndronin aq afër njëri-tjetrit, ndërsa kuajt vazhdonin punën e tyre pikërisht në rrugën e kalldrëmtë, ku ecnin biznesmenët me këpuçet me shkëlqim, në rrugën për në shtëpi. Kudo kishte shenja italiane në dyqane, djali në cep reklamonte “Postën e Mbrëmjes”, që ishte gjithashtu italiane. Nuk kundërmonte vetëm erë hudhrash e plehu organik, por edhe vere të fermentuar.

Ishte vendi më i bukur që kishte vizituar Xhina. U hutua fare. Me gojën e hapur nga lumturia, thithte ajrin, teksa kali i tyre që po ngordhte, mezi bënte një hap në minutë. Kishte kohë të ëndërronte për djathin e dhisë dhe salsicet që lëkunden nga grepat jashtë vitrinave. Një djalë tjetër me një karrocë po shiste molusqe të papërpunuara me lëng limoni, por bërtisnin në anglisht.

- Çfarë janë këto molusqet? - pyeti Benin dhe Herin.

Mimoja i rrahu krahun.

- Nuk do të hash asgjë që shitet nëpër cepa rrugësh. As edhe një karotë.

- Thjesht po pyes, Mimo. Nuk po ha.

- As mos pyet dhe mjaft u fole e para burrave që s'i njeh. S'është as e hijshme, as e përshtatshme.

Duke u ngritur, Xhina u largua dhe pa pse kishin rënë kambanat e kishës. Ishte një dasmë. Gjashtë pëllumba të bardhë ishin të lidhur me dy kuaj që prisnin dhe një karrocë të bardhë.

- Ne qershor ka shumë dasma, - tha Beni që nga ndenjësja e drejtuesit.

- Atëherë, si e shpjegon që jemi në korrik? - u tall Heri.

- Për ç'arsye do të martohej dikush të enjten në mbrëmje, në korrik? Kishat janë të rezervuara. I përshtatin datat e dasmës kur të munden, - u përgjigj Beni, teksa vështroi me dashamirësi nusen dhe dhëndrin që dilnin nga dyert e kishës.

Burri me harmonikë po luante dhe këndonte "Trëndafilim im i egër irlandez". Xhina dhe Beni kishin pothuajse të njëjtat shprehje fytyre ndërsa shikonin skenën, pëllumbat e bardhë që lëshoheshin e fluturonin larg. Mimoja dhe Heri shprehnin ndjesi tërësisht të ndryshme: ajo pikëllim e ai stres. Salvoja as po i hidhte sytë në atë që po ndodhte.

- Do të lëvizë ndonjëherë ky kalë? - e pyeti Salvoja Benin.

- Zgjedhëm moment të vështirë për të udhëtuar.

- Ndoshta duhet të zbresim e të ikim me këmbë.

- Po ti s' di ku të ikim, Salvo, - tha Xhina.

- Më mirë të lëvizim sesa të qëndrojmë këtu në vend numëro.

- Pothuajse arritëm, - tha Beni. - Edhe një bllok, një kthesë në të djathtë dhe arritëm në "Rrugicën e Gëlqeres".

- Duhet të ketë ndonjë mënyrë më të mirë për të ecur përmes qytetit, - tha Salvoja.

- Përmes qytetit? - ia ktheu Beni. - Mos the gjë përmes qytetit?

- Oh, jo! O Zot! - bërtiti Heri deri në qiellin e nxirë.

- Dëgjoni, fëmijët e mi dhe do të kuptoni, - recitoi Beni me zë të lartë, pa iu drejtuar dikujt konkretisht. - Nga udhëtimi i mesnatës së Pol Reverit / Më tetëmbëdhjetë prill, në shtatëdhjetë e pesën / Vështirë se ndonjëri është tani gjallë / Kush e kujton atë ditë dhe vit të famshëm.

Xhina e dëgjoi me vëmendje.

- Ç'është kjo poemë?

- Oh, jo, - i tha Heri. - Mos e ndërprit, se fillon nga e para, pastaj.